



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 264/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike Kosovës (PDK), dega në Mitrovicë për shkak të vendosjes së bilbordeve në vend të rezervuar për subjekt tjetër politik, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Mitrovicë.

### **Arsyetim**

Me datën 17.10.2013, subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se është bërë vendosja e bilbordeve në vendin e rezervuar për subjektin e AKR-së. Në cilësinë e provës, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur deklaratatë të personave në cilësinë e dëshmitareve.

Në deklaratën e dëshmitarit Ibrahim Bala theksohet se lidhur me posterin i cili është dashur të vendoset para tunelit të Mitrovicës i cili gjendet në lagjen Bajri ka ardhur deri te mosmarrëveshja në mes të dy subjekteve politike AKR-së dhe PDK-së. Me tutje deklaruesi thekson se nuk ka qenë në vendin e ngjarjes kur është hequr fotografia e Avni Kastratit, dhe nuk e di se kush e ka hequr, por me vonë thotë se kam takuar personat të cilët me kompaninë e vet e kanë marrë për të kryer këtë punë nga organi kompetent. Gjithashtu thekson se nuk e di se kush e ka paguar atë vend, por këtë duhet të dij kompania e caktuar.

Në deklaratën e dëshmitarit Fidan Mehmeti, theksohet se persona të partisë së PDK-së, në dalje të tunelit, në mënyrë antiligjore dhe jo civilizuese kanë penguar puntorët e kompanisë e cila bën ngjitjen e bilbordeve. Në deklaratën e Regjep Alidemaj, Abedin Pllana dhe Bajram Hasani theksohet se me datë 7.10.2013, kanë shkuar në vendin e ngjarjes, ku subjekti politik PDK, ka shkelur rregullat ligjore dhe ligjin në fuqi të zgjedhjeve lokale, me pretendimin se ky subjekt ka vendosur bilbordat në vendin ku kompania kishte vendosur bilbordat e subjektit politik të AKR-së, në bazë të pagesës, si dhe individë të PDK-së kanë penguar kryerjen e punëve të kësaj kompanie.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik më datën 18.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.10.2013 deri në ora 14:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK

me të cilen konsideron se janë të pabaza pretendimet e AKR-së, lidhur me shkeljen e rregullave të përcaktuara në LZP. Në përgjigjen në ankesë të këtij subjekti theksohet se posteri i kandidatit për kryetar të Mitrovicës nga radhët e PDK-së, ka qenë i vendosur në vendin për të cilin bëhet fjalë shumë kohë më parë, dhe se ky vend nuk ka qenë i rezervuar ose i parapaguar nga asnjë subjekt politik. Me tutje theksohet se njerëz të subjektit politik të AKR-së kanë shkuar dhe e kanë hequr fotografinë e kandidatit të PDK-së, dhe kanë vendosur simbolet e tyre, nën pretendimin se vendin e kanë kontraktuar nga një kompani, dhe se lidhur me këtë përafatësuesit e AKR-së, nuk kanë ofruar dëshmi se vendin e kanë paguar dhe të rezervuar. Poashtu në përgjigjen në ankesë theksohet se përkunder që është hequr fotografia e kandidatit të PDK-së, aktivistet e këtij subjekti nuk kanë tentuar ta vendosin sërish atë dhe në vend të saj janë simbolet e AKR-së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet e parashtruesit të ankesës se subjekti politik PDK, ka vendosur bilborde në vendin e rezervuar për subjektin politik AKR, nuk qëndrojnë ngase nga dëshmitë e ofruara nga parashtruesi i ankesës nuk mund të vihet në dyshim se është kryer një veprim i tillë, për arsye se ankesës përveq deklaratave të personave në cilësinë e dëshmitareve, nuk i është bashkangjitur asnjë dëshmi tjetër bindëse se subjekti në fjalë ka paguar ose ka rezervuar kompaninë e cila kryen ngjitjen e bilbordeve si dhe nuk dihet se për cilën kompani bëhet fjalë.

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për të u administruar si provë relevante nga deklaratat e personave në cilësinë e dëshmitarëve, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe në kuptim të nenit 115.1, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 264/2013 më datën 25.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*